





	<p style="text-align: center;">Majmuni gjyqtar</p> <p style="text-align: center;">übersetzt von Gladiola Sadiku</p>
	<p>Shumë kohë më parë, kur pothuajse të gjitha kafshët sorollateshin të lira dhe vetëm pak prej tyre banonin me njerëzit, një qen dhe një mace jetonin në shtëpinë e një dijetari.</p> <p>Një ditë dijetari mori si dhuratë një tortë të sapopjekur.</p> <p>Meqenëse ai duhet të largohej disa orë nga shtëpia, e vendosi atë për siguri mbi një parvaz druri, që ishte i varur në mur.</p>
	<p>Macja e kishte vëzhguar me kujdes dijetarin dhe, sapo ai doli nga dera e shtëpisë, u hodh te kolltuku i thurur, që ishte pranë dritares, nga atje te tavolina, dhe prej atje ajo mori guximin të kërcejë deri te parvazi i drurit.</p> <p>Gozhda që lidhte parvazinin në mënyrë jo shumë të sigurtë me një litar të thurur bambuje, nuk e përballoi dot këtë sulm të maces.</p> <p>Parvazi prej druri ra poshtë me një zhurmë gjëmuese së bashku me tortën dhe macen.</p> <p>Ndërkohë qeni shtriqej i përgjumur në diell dhe priste ardhjen e të zotit.</p>
	<p>I trembur nga zhurma e papritur, ai u hodh përpjetë dhe nxitoi për në dhomë.</p> <p>Kur e pa tortën, që kundërmonete aromë të mirë, nën kthetrat e maces, ai iu hodh asaj dhe donte t`ia mernte.</p> <p>Macja u mbrojti duke u ngërdheshur dhe i dha banorit tjetër të shtëpisë një goditje të fortë në hundë.</p> <p>Qeni klithi.</p>

	<p>Një majmun stërvitej ndërkohë mbi murin e shtëpisë dhe shihte me kureshtje nga dritarja.</p> <p>- Pse po grindeni ju të dy në një mot kaq të bukur? - pyeti ai duke qeshur.</p> <p>Qeni lehu si i tërbuar:</p> <p>- Kjo mace e padobishme dhe hajdute ka vjedhur tortën e zotërisë sonë!</p> <p>- Ç` të hyn në punë ty kjo gjë? – mjaulliu macja me zemërim.</p> <p>- Ndërsa ti po dremisje me përtesë në diell, unë hoqa shumë. E kam fituar tortën me shumë mundim.</p> <p>- Bishë e paturpshme dhe egoiste! - rënko i qeni, - mendon, se mund ta hash vetëm tortën? Ajo i përket zotërisë sonë, ndaj edhe unë kam të drejta mbi atë.</p>
	<p>- Ndaloni zënkën! - tha majmuni.</p> <p>- A nuk ju mjafton të dyve gjithë kjo tortë?</p> <p>- Unë shoh që atje mbi tavolinë është një peshore.</p> <p>- Do jua ndaj gjahun në dy pjesë të barabarta.</p> <p>Macja dhe qeni ranë dakord me këtë propozim.</p>
	<p>Të emocionuar ndiqnin se si majmuni ndante tortën dhe vendoste një gjysëm të saj në njëren pjatë të peshores, dhe gjysmën tjetër në pjatën tjetër të saj.</p> <p>Njëra nga pjatat e peshores ra poshtë.</p> <p>- Kjo copë është ndoshta pak më e rëndë, - tha majmuni me një çehre serioze duke shkërmoqur disa thërrime nga copa dhe i futi ato në gojë duke i shjuar.</p> <p>Qeni dhe macja pritnin të shihnin, që pjata e peshores të ngrihej përsëri ngadalë.</p> <p>- Tani është mirë, - thërriti qeni.</p>
	<p>- Jo, - tha majmuni prerazi.</p> <p>- Kjo copë e tortës është ende më e rëndë.</p> <p>Nuk duhet të më quajnë më pas gjyqtar të padrejtë.</p> <p>Në këto fjalë e sipër ai ndau edhe një copë të vogël nga torta dhe e futi në gojë.</p>

	<p>Por, ai kishte marrë më shumë, sepse tani u ul pjata tjetër e peshores.</p> <p>Majmuni murmuriti disa fjalë të pakuptueshme dhe filloi të ndante nga copa e dytë njëra pas tjetrës thërrimet dhe t'i fuste ato në gojë me qetësi, derisa të dyja pjatat e peshores iu afruan pak nga pak njëra- tjetrës.</p>
	<p>Në momentin e fundit ai mori përsëri më shumë nga copa më e madhe e tortës, kështu që tani kjo u bë më e vogël se tjetra dhe pjata e peshores u ngrit.</p> <p>Ai duhet t'ia niste punës edhe njëherë nga fillimi.</p> <p>Kjo gjë u përsërit aq shpesh, derisa njëra pjatë e peshores u zbras komplet dhe në pjatën tjetër mbeti vetëm një copëz.</p>
	<p>Atëherë ai u inatos dhe i bërtiti qenit dhe macës:</p> <p>- Ju ziheni për një arsye kaq qesharake dhe më mundoni mua si arbitër?</p> <p>Duhet t'ju vijë turp!</p> <p>Që të mbizotërojë përfundimisht paqja, unë po e ha vetë edhe këtë copëz të tortës.</p> <p>Ai e futi në gojë edhe kafshatën e fundit dhe kërcëu jashtë dritares.</p> <p>Qeni dhe macja e ndoqën duke e parë me habi.</p>
	<p>- Ky është shpërblimi yt tani! - u ngërdhesh macja.</p> <p>- Pse ishe kaq kurnace, - rënkoi qeni dhe u kthye zvarrazi në vendin e tij në diell.</p> <p>- Nuk mund t'i besosh më askujt, - brumbulliu ai dhe fjeti përsëri.</p>
	<p style="text-align: center;">Fund</p>

